



Analiza epidemiologjike mujore

(Pasqyra 14 Sh)


ANALIZA EPIDEMIOLOGJIKE MUJORE

TETOR, 2017

Analiza epidemiologjike e sëmundshmërisë infektive bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh. Pasqyra14-Sh plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me poste elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, ISHP brenda datës 10 të çdo muaji. Në muajin nëntor 2017 kanë raportuar 34 rrethe, nuk kanë raportuar dy rrethe, Kavajë dhe Has.


❖ Sëmundjet diarreike

Gjatë muajit tetor 2017 vëmë re se kemi të njëjtën incidence të sëmundjeve diarreike për 100.000 banorë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, tetor 2016, incidenca 233.52.



Grafiku 1. Numri i rasteve me sëmundje diarreike, tetor 2016 dhe 2017 raportuara nga DRSH/DSHP-te.

Rrethet me numrin më të madh të rasteve me Salmoneloze joti fide për muajin tetor 2017 janë: Shkodër (25 raste), Tirane (7 raste) dhe Berat (3 raste). Shigeloze janë: Shkodër (16 raste), Kukës (4 raste) dhe Dibër (3 raste) dhe Lezhe, Librazhd, Tirane dhe Vlore vetëm me një rast. Numri i toksikoinfeksioneve alimentare në tetor 2017 ka një rritje në krahasim muajin tetor 2016 dhe rrethet me problematike janë: Bulqizë (69), Kukës (65) dhe Berat (52). Gastroenteritet të paspecifikuar janë të shpërndara në të gjitha qarqet e vendit. Duhet theksuar që numri i lartë i rasteve të raportuara me toksikoinfeksione alimentare dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rrethëve të diagnozës së sakte klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.




Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve sipas DRSH/DSHP-ve, tetor 2016 dhe 2017.

❖ **Zoonozat**


	Tetor (Raste 2017)	Incidenca (raste/100,000) 2017	Tetor (Raste 2016)	Incidenca (raste/100.000) 2016
Antraks (Plasje)	1	0.03	0	0
Brucelozë	5	0.2	6	0.2
Leptospirozë	3	0.1	4	0.1
Tbc ekstrapulmonar	11	0.4	2	0.07
Rikecie	0	0	0	0

Tabela 1. Shpërndarja e zoonozave numri total i rasteve (Bruceloze, Antraks, Leptospirozë, Tbc ekstrapulmonar, Rikecie në muajin Tetor 2017 krahasuar me muajin Tetor 2016.



Grafiku 3. Shpërndarja e zoonozave në numër total rastesh Tetor 2017 krahasuar me muajin Tetor 2016.


Bruceloza



Grafiku 4 Shpërndarja gjeografike e Brucelozes sipas rretheve në muajin Tetor 2017 krahasuar me muajin Tetor 2016.

Ne total janë raportuar 5 raste me Brucelozë në muajin Tetor 2017 kundrejt 6 raste të raportuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rastet janë raportuar nga rrethet Dibër, Fier, Librazhd Pogradec, Mallakastër përkatësisht me nga 1 rast.


Antraksi



Grafiku.5 Shpërndarja e rasteve të Antraksit sipas rretheve në muajin Tetor 2017 krahasuar me Tetor 2016.

Ne total është raportuar 1 raste me Antraks ne muajin Tetor 2017 kundrejt 0 raste të raportuar në Tetor 2016. Rasti është i konfirmuar me laborator nga rrethi Sarande i grupmohës 60+vjeç.

Leptospiroza




Grafiku 6. Shpërndarja gjeografike e Leptospirozës sipas rretheve në muajin Tetor 2017 krahasuar me muajin Tetor 2016

Në total për muajin Tetor 2017 janë raportuar 3 raste me Leptospirozë kundrejt 4 raste të raportuar në muajin Tetor 2016. Rastet e raportuara ne tetor 2016 i përkasin rretheve Saranda, Elbasan, Fier, Lushnje perkatesisht me nga 1 rast.

3. Tbc ekstrapulmonar

Në total në muajin Tetor 2017 janë raportuar 11 raste kundrejt 2 rasteve të raportuar në muajin Tetor 2016.

Rastet janë raportuar nga rrethet Lezhe 4 raste dhe Tirana 7 raste.



Grafiku 7. Shpërndarja gjeografike sipas rretheve e Tbc ekstrapulmonar Tetor 2017 krahasuar me Tetor 2016.

Rikecie (0 raste) te raportuar në Tetor 2017.

❖ Sëmundjet e PKI

Fruthi:

Nga rrethi i Pogradecit janë raportuar 3 raste te dyshuara për fruth te cilët janë fëmije qe i përkasin komunitetit egjiptian dhe rom për te cilat u krye hetimi epidemiologjik.

Rastet janë dy motra 6 dhe 8 vjeç te komunitetit egjiptian nga fshati Rrëmenj-Pogradec dhe një fëmijë 11 vjeç, me kontakte në Maqedoni.

Të tre rastet janë të pavaksinuar ndaj Fruth /Rubeolës dhe rezultuan pozitive për IgM ndaj Fruthit.

Rastet janë klasifikuar të importuara

Në kuadër të hetimit epidemiologjik të mëtejshëm të shpërthimit u krye gjurmimi dhe identifikimi i kontakteve në komunitet dhe në një institucion shkollor që mbledh fëmijët e komunitetit egjiptian dhe rom në Pogradec të moshës së kopshtit dhe arsimit 9-vjeçar, për raste të reja si dhe u verifikua statusi i vaksinimit.


Gjithashtu u krye edhe vaksinimi me një doze MMR i te gjithë fëmijëve te institucionit te sipërpërmendur.

Varicele:.

Rastet me varicele hasen kryesisht ne grupmoshën pediatrike 0-14 vjeç dhe ne kolektiva te mbyllura si institucionet parashkollore çerdhe kopshte dhe shkolla ne forme shpërthimesh te kufizuara.

❖ Ethe hemorragjike


Nga survejanca e SMBS dhe survejanca e bazuara ne rast, gjate periudhës Tetor 2017 krahasuar me te njëjtën periudhe Tetor 2016, është vene re nje trend ne rritje i rasteve te dyshuara me ethe hemorragjike, përkatësisht 2 raste te dyshuara ne muajin Tetor 2017, te cilat kane rezultuar negative për EHKK dhe vetëm një nga rastet ka rezultuar pozitiv për EHSR, ndërkohe qe gjate muajit Tetor 2016 kemi patur një rast te dyshuar për ethe hemorragjike nga ku ka rezultuar negative për EHKK dhe EHSR. Rasti pozitiv për EHS, gjate muajit Tetor 2017, ishte i fshatit Kastriot, qarkut te Peshkopisë, e gjinisë femër, i grupmoshës + 60 vjeç.



Grafiku 8 Totali i rasteve te dyshuara me diagnozen Ethe hemorragjike gjate periudhes Tetor 2016 dheTetor 2017

❖ Meningoencefalite

Për sa i përket rasteve të dyshuara me diagnozën Meningoencefalite, kemi një trend në rritje të hasjes së rasteve të dyshuara meningit viral aseptik gjatë periudhës Tetor 2017 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.



Grafiku 9. Totali i rasteve të dyshuara me diagnozën meningoencefalite gjatë periudhës Tetor 2016 dhe Tetor 2017


Gjatë periudhës Tetor të viteve 2016 dhe 2017, nuk kemi asnjë raportim të rasteve me meningit bakterial meningokoksik dhe jo meningokoksik. Në lidhje me totalin e meningoencefaliteve gjatë periudhës Tetor 2016 dhe Tetor 2017, kemi predominim të gjinisë meshkuj në raport 3:1, me shpërndarje të barabartë si në grupmoshën pediatrike dhe grupmoshën e rritur. Theksojmë që rastet janë raportuar dhe hetuar njëkohësisht në rrethet Elbasan, Kuçovë, Durrës dhe Lushnjë.

❖ Hepatitet virale

Në raportimin mujor të semundshmerise infektive gjatë muajit tetor 2017 janë raportuar në total 24 raste me hepatite virale akute nga të cilat 3 janë të hepatite virale paspecifikuar, 3 raste me Hepatit viral A, 14 raste me Hepatit viral B dhe 3 raste me hepatite virale as A as B.

Periudha kohore	Hepatiti i paspecifikuar	Hepatit viral A	Hepatit viral akut B	Hepatit viral as A as B
Tetor 2016	17	4	10	2
Tetor 2017	3	3	14	3

Siç shihet, edhe nga grafiku i mëposhtëm, në krahasim me të njëjtin muaj një vit më parë, numri i rasteve të raportuar me hepatite virale të paspecifikuar ka pësuar ulje këtë vit. Duhet theksuar se shumica e rasteve me Hepatit viral të paspecifikuar gjatë muajit tetor 2016 i përkisnin moshës 0-14 vjeç dhe janë kryesisht nga rrethi i Tiranës dhe Lezhës. Nga hetimi epidemiologjik i kryer për këto raste rezultoi se janë raste sporadike pa lidhje epidemiologjike mes tyre. Gjithashtu rastet me HBV paraqesin rritje këtë muaj.



Grafiku 10. Numri i rasteve me hepatite virale, tetor 2016 dhe 2017.

E rëndësishme është të theksohet se këtë muaj numri rasteve me hepatite virale A, B dhe as A as B është hasur në grupmoshat adulte (>25 vjeç) ndërsa me hepatite virale të paspecifikuara 4-19 vjeç. Vazhdimi i raportimit të rasteve me hepatit viral të paspecifikuara ndodh për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme laboratorike për diagnostikimin e tyre në laboratorët mikrobiologjike të DSHP në rrethet e vendit. Në lidhje me shpërndarjen sipas rretheve, gjatë këtij muaji Dibra ka raportuar rastet me Hepatite virale të paspecifikuara ndërsa Tirana, Shkodra, Vlora dhe Durrësi me Hepatit viral B.

❖ Tuberkulozi pulmonar.

Gjatë periudhës Tetor 2017, krahasuar me muajin Tetor 2016, vihet re një rritje e numrit të rasteve të raportuara me tuberkuloz pulmonar përkatësisht nga 22 raste në Tetor 2016 në 32 raste në Tetor të vitit 2017. Duhet theksuar se burimi i të dhënave të muajit Tetor 2017 është Programi Kombëtar i Tuberkulozit pranë SUSM, ndërkohë të dhënat e muajit Tetor 2016 i përkasin SMBS. Nëse i referohemi të dhënave të SMBS për muajin Tetor 2017 shikojmë se kemi nënraportim të rasteve (21 raste) nga 32 rastet që janë raportuar nga Programi Kombëtar i Tuberkulozit. Përsa i përket shpërndarjes sipas rretheve në të dyja periudhat, Tirana paraqet numrin më të madh të rasteve në të dy periudhat, në Tetor 2017 raportohen 16 raste me vendbanim Tirane; ndërsa në Tetor 2016 raportohen 13 raste në Tirane. Shpërndarja sipas grupmoshave tregon se rastet e raportuara në muajin Tetor 2016 i përkasin adultëve (7 raste në grup-moshën > 65vj.; 6 raste në grup-moshën 20-24 vjeç;) dhe vetëm dy raste në grupmoshën 10-14 vjeç, ndërsa në periudhën Tetor 2017 kemi shpërndarje në disa grupmosha, por grupmosha më e hasur 11 raste i përkasin grup-moshën > 65 vjeç.; 4 raste në grup-moshën 20-24vj.; ndërsa grupmosha më e hasur (15-19 vjeç.) paraqitet me një rast.




Figura.11. Paraqitja e totalit te rasteve (te dyshuara dhe te konfirmuara) me diagnozen Tuberkuloz pulmonar, gjate periudhes Tetor 2017 dhe Tetor 2016.

❖ HIV/AIDS

Survejaca e SMBS ne lidhje me diagnozën AIDS paraqet zero raste te raportuara nga rrethet përkatësisht ne muajt Tetor 2016 dhe Tetor 2017. Kjo për disa arsye, pasi rastet qe diagnostikohen me HIV ndiqen klinikisht pranë Shërbimit Infektiv ne QSUT, ne lidhje me këto raste është ruajtur informacioni ne mënyre konfidenciale. Sipas te dhënave te Programit Kombëtar te HIV/AIDS, gjate muajit Tetor 2016 janë raportuar 7 raste HIV pozitive, ndërsa ne muajin Tetor 2017 janë diagnostikuar 9 raste HIV pozitive. Shpërndarja sipas gjinisë e rasteve te muajit Tetor 2016 paraqet 7 raste tek meshkujt; ndërsa ne Tetor te 2017, 7 rastet janë meshkuj dhe 2 raste janë femra. Shpërndarja sipas grupmoshës tregon se grupmosha qe predominon mbetet 25-45 vj ne te dyja periudhat, ne tetor te vitit 2017 është diagnostikuar një rast (7 vjeç) ne grupmoshën i diagnostikuar me rruge vertikale 0-15 vjeç, një rast ne grup-moshën 16-24vj., ndërsa ne tetor 2016 raportohet një rast ne grup-moshën 16-24 vjeç.




Figura12. Raste te diagnostikuar me HIV, Tetor 2016 dhe Tetor 2017

Bashkëngjitur janë tabelat me të dhënat e sëmundshmerise infektive për muajin tetor 2017 sipas rretheve dhe sipas grupmoshave.

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit të Semundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjise, Programi Kombëtar i Tuberkulozit**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi, Donika Bardhi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I
SHENDETIT
PUBLIK

DEKSI